

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“Frigo Creative” shpk**

- 1) Sot, më 22/09/2023, une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Frigo Creative” shpk.
  - a) Themeluesi i shoqërisë eshte:
  - b) Ismet Sylejmani, atësia Ali, shtetas Kosovar, me numër pasaporte P01302159 i datëlindjes 30.01.1966, lindur në Breg i Zi dhe banues në Fshati Bregu I Zi, Rruga Ali Sylejmani, nr 7, Lipjan, Kosove; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1  
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është **“Frigo Creative” shpk**.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:  
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:  
Tregti, import - eksport, me shumice e pakice te pajisjeve elektro-shtepiake, mallrave te ndryshem ushqimore dhe industriale, konfeksione etj. Transport per vete dhe per te trete. Shoqëria do te ushtroje cdo aktivitet i cili parashikohet nga ligji dhe vleresohet si fitimprures nga asambleja e ortakeve te saj.

**Neni 3:  
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:  
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Njesia Bashkiake Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga Andon Zako Çajupi, Ndërtesa Nr.3, Hyrja Nr.11, Kati 2, Ap. Nr.2, Tirane.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë

**Neni 5  
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000,000 (Nje milion) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- A) Ortaku themelues Ismet Sylejmani, zotëruesh i 1 (nje) kuote me vlerë të përgjithshme 1,000,000 (nje milion) Lekë, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6**  
**Organ i Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj

**Neni 7**  
**Administratori**

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Ismet Sylejmani, atësia Ali, shtetas kosovar, me numër pasaporte P01302159 i datëlindjes 30.01.1966, lindur në Breg i Zi dhe banues në Fshati Bregu I Zi, Rruga Ali Sylejmani, nr 7, Lipjan, Kosove; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

**Neni 8**  
**Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne përputhje te plote me ketë akt themelim dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë akt themelim, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.


**Neni 9**  
**Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**O R T A K U I V E T E M**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Frigo Creative" shpk**

**Sylejmani**

**Ismet**



Faqe 2 e 3  
Akti i Themelimit  
Frigo Creative shpk

*Faqe 3 e 3  
Akti i Themelimit  
Frigo Creative shpk*